



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kaçanikut (KK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Komuna ka shpenzuar mjete në vlerë 285,737€ nga kategoritë jo adekuate;
- B2 Pasuritë kapitale në PFV janë nënvlerësuar për 33,059€.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Kaçanikut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- B3 Hyrja në obligime kontraktuale pa buxhet dhe fonde të mjaftueshëm;
- A1 Tejkallim i vlerës së kontraktuar të kontratës kornizë dhe realizimi i saj jo në përputhje me peshën e përcaktuar në kontratë;
- A2 Mangësi në raportim të përfituesit të subvencioneve.
- C1 Vonesa në realizimin e projekteve kapitale
- B4 Vonesa në pagesën e obligimeve ndaj kontraktuesve;

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Kaçanikut.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Kaçanikut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Kaçanikut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Kaçanikut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Kaçanikut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi identifikuar fusha në të cilat nevojiten përmirësime në menaxhimin financiar dhe kontrollin, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Dobësitë evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si : keq klasifikimi i shpenzimeve, hyrja ne obligime kontraktuale pa buxhet dhe fonde të mjaftueshëm, vonesa në realizimin e projekteve, dobësi në menaxhimin e kontratave publike, mos raportimi nga menaxherët e kontratave në sistemin e-prokurimit, mos harmonizim të kontratave të punës sipas kërkesave ligjore, mangësi në menaxhimin e kontratës me çmim të poentuar, vonesa në deponimin e mjeteve në llogari bankare dhe vonesa në pagesën e obligimeve financiare.

Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me 13 rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja, shtatë (7) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht I përsëritur . Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja B1 - Klasifikim i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate

**Gjetja** Ligji Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, neni 15 parasheh që në rastin e komunës, ndarjet buxhetore nga “Rezerva” me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbartimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ. Këto mjete duhet të merren brenda kufijve buxhetor të përcaktuar me qarkore, përjashtimisht mjetet nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Ndërsa, Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i parasë publike, neni 18, përcakton që, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, plani kontabël i Thesarit përcakton kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që organizatat buxhetore duhet të aplikojnë.

Shpenzimet e realizuara nga kodet për vendime gjyqësore janë 1,322,602€. Prej kësaj shume, 1,118,900€ janë në kategorinë e investimeve kapitale, 190,607€ në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa 13,094€ në kategorinë e shpenzimeve komunale.

Komuna nuk kishte planifikuar fonde rezervë për mbulimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore/përmbartimore, në përputhje me kërkesat ligjore. Si pasojë, shpenzimi në vlerë 250,955€ është klasifikuar gabimisht në kategorinë e investimeve kapitale, pasi nuk përfaqëson shpenzime kapitale. Këto mjete janë përdorur për paga jubilarë dhe kualifikime në vlerë 63,810€, si dhe për shujta dhe shpenzime tjera në vlerë 187,145€, në bazë

të vendimeve gjyqësore që burojnë nga kontrata kolektive për mësimdhënësit.

Shpenzimet në vlerë 34,782€ janë klasifikuar gabimisht në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, pasi që këto mjete janë përdorur për paga jubilarë dhe kualifikime, në bazë të vendimeve gjyqësore që burojnë nga kontrata kolektive për mësimdhënësit.

Komuna ka ndërmarrë masa për reduktimin e kostove shtesë përmes pajtimeve gjyqësore, duke arritur në disa raste marrëveshje me paditësit për mos aplikimin e 8% dhe 10% të shpenzimeve administrative dhe përmbartimore.

Po ashtu, për shpenzimet e realizuara drejtpërdrejt nga thesari, për 7 mostra në vlerë 240,201€, nuk janë siguruar dëshmi mbështetëse nga komuna. Sipas shpjegimit të komunës, dokumentacioni ndodhet në thesar dhe nuk janë ndërmarrë veprime për sigurimin e tij për qëllime të evidencimit dhe raportimit buxhetor.

Pagesat për paga jubilarë, kualifikime dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive me vendime gjyqësore, shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet.

#### **Ndikimi**

Pagesat e kryera nga kategoritë jo adekuate të shpenzimeve ndikojnë në raportimin e drejtë financiar, mbivlerësim/nënvlerësim të kategorive të shpenzimeve, ku për 250,955€ janë mbivlerësuar investimet kapitale ndërsa janë nënvlerësuar pagat për 98,592€ dhe mallrat dhe shërbimet 152,373€, të njëjtat kanë ndikuar në shpenzimin e mjeteve nga projektet kapitale të buxhetuara. Mungesa e dëshmive mbështetëse rrit rrezikun për shpenzime të paarsyetuara dhe dobëson kontrollin e brendshëm dhe transparencën financiare.

#### **Rekomandimi B1**

Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B2 - Mos regjistrimi i pasurive në regjistra kontabël**

#### **Gjetja**

Sipas Rregullores Nr. 02/2013 "Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore", neni 6 përcakton se pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria". Po ashtu, neni 11.3 përcakton se - Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimin të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi.

Në dy raste kemi vërejtur që pasuritë e blera në vitin 2025 në vlerë prej 33,059<sup>5</sup>€ nuk janë regjistruar në SIMFK. Si rezultat i kësaj Pasuria kapitale (mbi 1,000€) e prezantuar në PFV është nënvlerësuar për këtë vlerë. Po ashtu, në pesë raste në vlerë prej 35,136€, nuk ishin evidentuar në sistemin e-pasuria me qëllim hyrje/daljes.

Më tej, janë identifikuar gjashtë projekte kapitale të cilat përkundër që është bërë raporti përfundimtar i projektit janë të identifikuara si investime në vijim në SIMFK.

Procesi i e-Pasurisë u është ngarkuar zyrtarëve të tjerë si detyrë shtesë, përdërisa zyrtari ka filluar punën në muajin qershor 2025, i cili përkundër kërkesës sonë për trajnim, atij ende nuk i është ofruar trajnimi i nevojshëm. Si rrjedhojë, zyrtari nuk ka arritur të sigurojë të gjitha informacionet e nevojshme për të realizuar regjistrimin e plotë dhe korrekt të këtyre materialeve.

**Ndikimi**

Mos regjistrimi i pasurisë në regjistrat përkatës të pasurive jo financiare ndikon në prezantim jo të drejtë të pasurive në PFV dhe pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë me rrezikun që pasuritë të humbin apo keqpërdoren.

**Rekomandimi B2**

Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar saktë në regjistrat kontabël sipas kërkesave ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja B3 - Hyrja ne obligime kontraktuale pa buxhet dhe fonde të mjaftueshëm

#### Gjetja

Sipas Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2025, neni 12 paragrafi 7 limitet në zotime dhe shpenzime. Nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga OB-të vetëm në raste se shpenzime e tilla për kosto totale të projektit janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2025 dhe për dy (2) vitet në vijim. Te tabela 4.2 Financimi i Investimeve Kapitale Komunale, planifikohen financimet e projekteve dhe shumën e ndarë që duhet të realizohen brenda tri (3) viteve.

Kemi identifikuar 5 kontrata të nënshkruara pa fonde të mjaftueshme para nënshkrimit të kontratës:

- Rregullimi i sistemit të nxemjes qendrore të objektit të administratës Komunale (projekti 52636) ishte nënshkruar në vlerë 188,906€, e datës 04.03.2025, përderisa me ligjin e buxhetit 2025 janë planifikuar 60,000€, përderisa nuk kishte projeksion buxhetor për vitet vijuese;
- Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHFMU "Idriz Seferi", Bob (projekti 53272) ishte nënshkruar në vlerë 366,999€, e datës 23.08.2024, përderisa me ligjin e buxhetit 2024 janë planifikuar 200,000€, ku në vitin 2025 janë planifikuar 200,000€, si vazhdim nga viti 2024, përderisa nuk kishte projeksion buxhetor për vitet vijuese;
- Ndërtimi i murit mbrojtës të betonit të armuar në rrugën "Daut dhe Adem Rakoci" (projekti 56235) ishte nënshkruar në vlerë 108,132€, e datës 26.03.2025, përderisa me ligjin e buxhetit 2025 janë planifikuar 50,000€, përderisa nuk kishte projeksion buxhetor për vitet vijuese;
- Zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës Gryka e Kaçanikut në fshatin Kaçanik i Vjetër (projekti 56237) ishte nënshkruar në vlerë 149,952€, e datës 14.08.2025, përderisa me ligjin e buxhetit 2025 janë planifikuar 100,000€, më pas në ligjin e buxhetit të vitit 2026 janë parapa 60,000€, përderisa nuk kishte projeksion buxhetor për vitet vijuese;
- Ndërtimi dhe rregullimi i terreneve sportive në bashkësitë lokale Doganaj-Soponicë dhe Duraj (projekti 56344) ishte nënshkruar në vlerë 260,885€, e datës 01.08.2025, përderisa me ligjin e buxhetit 2025 janë planifikuar 50,000€, përderisa nuk kishte projeksion buxhetor për vitet vijuese.

Kjo dukuri ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit pa pasur buxhet të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës dhe pa fonde të mjaftueshme.

#### Ndikimi

Hyrja në obligime pa planifikime buxhetore dhe pa siguruar fondet e nevojshme, ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara, apo implikime buxhetore për vitin aktual, si dhe ngarkesë për buxhetin e vitit vijues.

#### Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha kontrollet e nevojshme funksionojnë gjatë tërë kohës, në mënyrë që para inicimit të procedurave të prokurimit të sigurohet se projektet kapitale janë të përfshira në ligjin e ndarjeve buxhetore dhe ka fonde të mjaftueshme buxhetore të ndara për të gjitha kontrata e lidhura.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

**Çështja A1 - Tejkalim i vlerës së kontraktuar të kontratës kornizë dhe realizimi i saj jo në përputhje me peshën e përcaktuar në kontratë**

**Gjetja** Neni 3, paragrafi 3.1 i kontratës përcakton që Vlera totale indikative e kontratës është 475,000€ (çmimi për njësi 239.80). Rregullorja nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, 54.15 Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dine sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në baze të rëndësisë se secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar.

Në kontratën kornizë të peshuar për "Mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale" e nënshkruar me datë 12.01.2024 në vlerë 475,000€, komuna gjatë realizimit të kësaj kontrate ka bërë tejkalimin e vlerës së kontraktuar për 47,500€ duke realizuar shpenzime totale prej 522,500€.

Po ashtu tek kontrata e njëjtë nuk ishte zbatuar raporti i peshimit të pozicioneve siç ishte përcaktuar me kontratë. Kjo pasi që, tek kategoria e parë ishte kontraktuar 40% apo 190,000€, ndërsa shpenzimi për këtë pozicion ishte 5.23€, kategoria e dytë ishte kontraktuar 30% apo 142,500€, ndërsa shpenzimi ishte 361,491, kategoria e tretë ishte kontraktuar 20% apo 95,000€, ndërsa shpenzimi ishte 18,497€, si dhe kategoria e katërt ishte kontraktuar 10% apo 47,500€, ndërsa shpenzimi ishte 5.50€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mangësive në planifikimin e saktë të nevojave dhe mbikëqyrjes së dobët nga ana menaxherit të kontratës.

**Ndikimi** Tejkalimi i vlerës së kontratës dhe kategorive sipas peshimit, ndikon në mungesë të transparencës për zgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulët. Kjo po ashtu, ndikonë në shpenzime të pa planifikuara buxhetore.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e kontratave kornizë, duke siguruar që shpenzimet të jenë në përputhje me vlerat e kontraktuara, me qëllim të shmangies së tejkalimeve buxhetore dhe përdorimit efikas të buxhetit të saj.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja A2 - Mangësi në raportim të përfituesit të subvencioneve**

**Gjetja** Marrëveshja e bashkëpunimit në mes Komunës dhe Islamic Relief Worldwide (IRW), neni 2.2 përcakton se fondet e komunës do të transferohen tek IRW, e cila pastaj do të raportoj dhe dëshmoj me faturat e shpenzimeve dhe raportet e shërbimeve të kryera.

Tek projekti dyvjeçar 2024/2025 i subvencionuar në bashkëfinancim nga Komuna dhe Islamic Relief Worldwide (IRW), për projektin "Mamografia dhe mbështetje bujqësore për personat në nevojë", ku komuna kishte participuar me 102,347€, IRW-ja nuk kishte ofruar raportet për shërbimet e kryera dhe faturat e shpenzimeve ashtu siç parashihej me dispozitat e marrëveshjes.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme dhe mungesës së përgjegjësisë për zbatimin e kërkesave ligjore lidhur me subvencionimin e OJQ-ve.

- Ndikimi** Mos dorëzimi i faturave të shpenzimeve, raportin e shërbimeve të kryera ndikon në mos transparencën e procesit dhe rritë rrezikun që fondet të mos shfrytëzohen në mënyrë efektive.
- Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e kontrolleve të brendshme adekuate për të garantuar që çdo shpenzim të mbështetet me dokumentacion të plotë përkatës, përfshirë faturat dhe raportet mbi shërbimet e kryera.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja C1 - Vonesa në realizimin e projekteve kapitale

- Gjetja** Sipas Rregullës Nr. 001-2022 për prokurimin publik dhe rregulloren për plotësim ndryshimin e saj që ka hyrë në fuqi në nëntor 2024, neni 70.23 menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Në kontratat e lidhura ndërmjet komunës dhe operatorëve ekonomik, janë përcaktuar afatet kohore të realizimit të kontratave. Po ashtu neni 71.2 përcakton se, aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës - amandamentimi i kontratës do të përgatitet nga Departamenti i Prokurimit. Amandamentimi i kontratës do të nënshkruhet nga palët që kanë nënshkruar kontratën bazë dhe do të ngarkohet në platformën elektronike.

Në gjashtë (6) raste të shpenzimeve për projekte kapitale, punimet nuk ishin realizuar konform planit dinamik siç parashihej me kontratë, si dhe nuk kishte vazhdim /amandamentim të kontratës.

Rastet e identifikuar janë:

- Kontrata "Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës Stagovë-Runjevë" e datës 13.03.2025 në vlerë 261,127€ nuk është kryer sipas planit të paraparë dinamik prej 70 ditë;
- Kontrata "Ndërtimi i rrugës që lidhë pjesën jugore të Kaçanikut me rrugë nacionale N2" e datës 05.05.2023 në vlerë 360,629€ nuk është kryer sipas planit të paraparë dinamik prej 24 muaj;
- Kontrata "Ndërtimi i trotuarit në rrugën regjionale Ahmet Kaçiku, segmenti restorant Natyra-Fusha e Pajtim, Faza e II-të" e datës 22.05.2025 në vlerë 239,760€ nuk është kryer sipas planit të paraparë dinamik prej 70 ditë;
- Kontrata "Ridizajnimi i hapësirës së Parkut të Qytetit përballë kalasë së Qytetit " e datës 30.09.2024 në vlerë 139,155€ nuk është kryer

- sipas planit dinamik 50 ditë;
- Kontrata "Ndërtimi i shkallëve për ngjitje mbi Gurin e Shpuar " e datës 25.04.2023 në vlerë 217,999€ nuk është kryer sipas planit dinamik përkatësisht deri me datë 26.04.2025;
  - Kontrata "Ndërtimi i murit mbrojtës të betonit të armuar në rrugën Daut dhe Adem Rakoci" e datës 25.04.2023 në vlerë 108,132€ nuk është kryer sipas planit dinamik përkatësisht deri me datë 26.04.2025.

Shkak i vonesave ishin kryesisht problematikave të kushteve të terrenit dhe një rast deri te ndërimi I menaxherit të kontratës, si dhe vendosja e afateve për realizim të projekteve pa një analizë të duhur, si dhe mos përgjegjësia e operatorëve ekonomik në kryerjen e punimeve sipas afatit të paraparë me kontratë.

**Ndikimi** Vonesat në realizimin e projekteve ndikojnë në mos arritjen e objektivave të komunës, dhe pamundësinë e shfrytëzimit të këtyre projekteve të cilat janë në shërbim të qytetarëve të komunës.

**Rekomandimi C1** Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontroleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigoroze në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat/ndëshkimet e parapara në kontratë.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B4 - Dobësi dhe vonesa në pagesën e obligimeve të papaguara**

**Gjetja** Neni 41 i Rregullës financiare nr. 01/20213/MF shpenzimi i parasë publike, përcakton që, OB duhet që çdo faturë të vlefshme për pagimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve të pranuar ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës. Po ashtu neni 24, paragrafi 1.3 përcakton se - Të gjitha faturat duhet të protokolohen dhe evidentohen në librin e faturave. Ndërsa, neni 6 i rregullës financiare nr. 02/2013 për Raportimin e Obligimeve të Papaguara të Organizatave Buxhetore, përcakton afatin për dorëzimin e raporteve për obligimet e papaguara prej 15 ditë pas përfundimit të muajit për gjendjen e muajit paraprak.

Lidhur me menaxhimin e obligimeve të papaguara janë identifikuar dobësitë si në vijim:

Në pesë (5) mostra të testuara në vlerë prej 79,943€, kemi vërejtur se Komuna nuk i kishte kryer obligimet financiare brenda afatit prej 30 ditësh. Vonesat ishin deri në pesë muaj nga data e pranimit të obligimit. Komuna nuk mban protokol për faturat e pranuar. Për më tepër raportet e obligimeve të papaguara nuk ishin raportuar nga muaji mars deri në muajin nëntor gjatë vitit 2025.

Vonesat ishin kryesisht të shkaktuara nga mungesa e mjeteve buxhetore dhe planifikim jo i mirë për kryerjen e obligimeve sipas afateve të përcaktuara. Mos mbajtja e protokollit për faturat e pranuar dhe mos raportimi i obligimeve ka ndodhur pasi komuna nuk ka zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm me rastin e pranimit dhe pagesës së faturave.

**Ndikimi**

Vonesat në pagesa ndaj furnitorëve, mos protokollimi i faturave si dhe mos raportimi i tyre në Thesar në baza periodike rrisin rrezikun që në periudhat e ardhshme komuna të ballafaqohet me padi gjyqësore/përmbarimore të cilat njëherit rezultojnë me shpenzime shtesë duke e rënduar buxhetin e komunës.

**Rekomandimi B4**

Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv në të cilin të gjitha obligimet financiare paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, faturat protokollohen, evidentohen si dhe procedohen për pagesë në mënyrë që maksimalisht të zvogëlohet vlera e obligimeve të papaguara në fund të vitit, njëherit edhe raportimi i tyre në Thesar të bëhet i plotë dhe në baza periodike të parapara me rregulla financiare.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna në vitin 2025 ishin 800,488€, derisa ishin planifikuar 950,401€, duke mos realizuar planin për 149,913€. Ato kanë të bëjnë kryesisht nga taksat për leje ndërtimore, tatimi në pronë, të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike, participimet, si dhe taksa tjera komunale. Arsye e mos përmbushjes së planit të të hyrave ishte realizimi i ulët i të hyrave nga tatimi në pronë, nga i cili ishin planifikuar 430,752€ dhe ishin realizuar vetëm 271,645€ apo 63%.

#### Çështja A3 - Vonesa në deponimin e të hyrave vetanake në llogari bankare

**Gjetja** Neni 11 paragrafi 2 i Rregullës Financiare 03/2010 për të hyrat parasheh se “Në fund të ditës paratë e grumbulluara në arkat e OB-ve duhet të depozitohen në total për çdo lloj të të hyrave përmes agjencive mbledhëse me faturë përmbledhëse të përcaktuara me numrin identifikues UNIREF”.

Gjatë testimit të mostrës në vlerë prej 2,395€ kemi vërejtur se Institucionet shëndetësore kishin vonesa në deponimin e mjeteve të inkasuara nga participimi i pacientëve në llogarinë e thesarit. Mjetet monetare ishin grumbulluar nga muaji janar- korrik/2025 dhe ishin deponuar në muajin gusht (data e deponimit 04.08.2025).

Kjo ka ndodh nga pakujdesia e zyrtarëve përgjegjës për t'i deponuar mjetet monetare në llogarinë bankare të thesarit.

**Ndikimi** Mbajtja e mjeteve pa i deponuar në llogari bankare për një periudhë të gjatë mujore, mund të ndikoj në humbjen apo tjetërsimin e mjeteve të mbledhura.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë se mjetet monetare të grumbulluara nga shërbimet në shëndetësi do të deponohen në fund të ditës.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja B5 - Mos përmbushja e kërkesës ligjore për inspektimin e pronave të paluajtshme

**Gjetja** Sipas Ligjit Nr. 06/L-005 Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 15 pika 1 dhe 2 e përcakton se: Inspektimi 1. Komuna inspekton pronat e paluajtshme brenda territorit të Komunës. Komuna mund të angazhojë inspektor privat për të ndihmuar në veprimtaritë inspektuese, 2. Veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzetë përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës dhe vetëm kur është e nevojshme për parcelat.

Komuna gjatë vitit 2025 nuk kishte arritur të bëjë inspektimin apo verifikimin e së paku 20% të pronave të regjistruara brenda territorit të Komunës.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të mangëta dhe angazhimeve të pamjaftueshme për verifikimin e pronave sipas kërkesave ligjore.

**Ndikimi** Mos aplikimi i kërkesës ligjore për inspektim të pronës së paluajtshme rezulton në mungesë të informacionit të saktë mbi pronën e tatueshme. Kjo situatë mundëson rrjedhjen e gabimeve në vlerësim, duke mos reflektuar gjendjen faktike në teren në krahasim me atë të evidentuar në Pro tax.

**Rekomandimi B5** Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje në vitin 2025 ishte 7,366,883€ prej tyre ishin shpenzuar 7,357,817€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 822 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 797. Gjatë vitit 2025 ishin punësuar 40 të rinj. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 51,820€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

#### Çështja A4 - Mos harmonizimi i kontratave të punës sipas kërkesave ligjore

**Gjetja** Neni 102 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, paragrafi 1 parasheh: “Me hyrje në fuqi të këtij ligji, obligohen të gjitha institucionet që të përgatisin dhe t’u ofrojnë zyrtarëve aktual për nënshkrim aktet e reja të emërimit dhe/apo kontratat e punës” dhe paragrafi 2 “Aktet e emërimit dhe/apo kontratat e punës nënshkruhen nga të gjitha palët dhe duhet të jenë në harmoni me përcaktimet e këtij ligji, Ligjit të Punës, si dhe Ligjit për Paga në sektorin publik”.

Nga testimi i 70 mostrave për pagat e personelit, në 45 prej tyre kemi identifikuar se kontratat e punës të nëpunësve të arsimit dhe shëndetësisë, nuk ishin përditësuar për të reflektuar nivelin e saktë të pagës bazë - koeficientit. Përkundër faktit se pagat e këtyre nëpunësve ishin përllogaritur sipas ligjit për pagat, megjithatë kjo nuk ishte përcjellur me harmonizim edhe në kontratat e tyre të punës.

Kjo kishte ndodhur si rrjedhojë e dobësive të kontrollit të brendshëm për të aplikuar saktë koeficientin e përcaktuar sipas ligjit për paga në kontratat e punës.

**Ndikimi** Kjo situatë ndikon në mos respektimin e kërkesave ligjore dhe krijon paqartësi, pasi që kontratat e punës nuk paraqesin nivelin e saktë të pagës bazë-koeficientit.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të sigurojë se kontratat e punës për nëpunësit e arsimit dhe shëndetësisë përditësohen dhe harmonizohen sipas kërkesave dhe afateve ligjore.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.3 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë në vitin 2025, ishte 1,816,938€, prej tyre ishin shpenzuar 1,769,139€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet për derivate, riparim dhe mirëmbajtje, furnizim me lëndë djegëse, komunalitë etj.

#### Çështja B6 - Dobësi në menaxhimin e kontratave përmes platformës elektronike të e -prokurimit

**Gjetja** Rregullorja nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70.2 përcakton që: “Vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet: i) në sistem të prokurimit elektronik nëpërmjet modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve; ii) nga menaxherët e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe iii) në pajtim me manualin për përdorim të modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve”. Më tutje, sipas nenit 70.24(f): “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.

Në bazë të mostrave të testuara, në pesë (5) raste, menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve nuk është mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

Kjo ka ndodhur si rezultat i moskryerjes së punës me përgjegjësi nga ana e menaxherëve të kontratave dhe mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë të tyre.

**Ndikimi** Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikojë në një menaxhim jo të mirëfilltë dhe transparent të kontratave nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

**Rekomandimi B6** Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.4 Të arkëtueshmet

Komuna në vitin 2025 ka shpalosur në PVF llogaritë e arkëtueshme në vlerë 2,529,644€. Kjo vlerë përbehet nga llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë në vlerë 2,263,059€, taksa nga ushtrimi i veprimtarisë 219,070€, taksat nga qiraja në vlerë 47,514€.

#### Çështja B7 - Mungesë e dëshmive të llogarive të arkëtueshme

##### Gjetja

Sipas nenit 26 të Ligjit 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) eurove. Derisa, me neni 27, përcakton që nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në kontratë për secilin lloj të të hyrave. Si dhe Rregullorja MF-Nr.01/2017 për Raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, neni 6 përcakton që, organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të sakte, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare.

Llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë për vitin 2025 ishin gjithsej 2,263,059€. Në 45 mostra të testuara me borxh total 144,255€, komuna nuk kishte dërguar vërejte dhe nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim ligjorë për mbledhjen e këtyre borxheve.

Në katër (4) raste të llogarive të arkëtueshme nga taksat për ushtrimin e veprimtarisë në vlerë 14,850€, dhe në tre (3) raste nga shfrytëzimi i pronës publike në vlerë prej 20,714€, komuna nuk posedon dëshmi burimore si faturë apo ndonjë dokument tjetër që konfirmon shumën e borxhit të prezantuar në PFV.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të duhur të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.

##### Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave vetanake ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake.

##### Rekomandimi B7

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e të arkëtueshmeve, si dhe rritjen e efikasitetit për arkëtimin e tyre duke ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore për inkasim.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) funksionon vetëm me drejtorin e NjAB-së.

#### Çështja A5 - Mangësi në funksionalizimin e NJAB dhe planit të auditimit dhe Komiteti i Auditimit

**Gjetja** Sipas Rreg. QRK-NR 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, neni 5 Kriteret për themelimin e Njesisë së auditimit të brendshëm dhe për zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm, 1.1 Subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë milionë euro të ketë së paku tre (3) auditorë të brendshëm. Sipas UA-MF nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik, Neni 6- Përbërja dhe Mandati i Komitetit të Auditimit, 1. Komiteti i Auditimit emërohet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe përbëhet nga tre (3) ose pesë (5) anëtarë. Kryesuesi i Komitetit të Auditimit nuk duhet të jetë në pozitën udhëheqëse, dy të tretat (2/3) e anëtarëve duhet të jenë të jashtëm, dhe pjesa tjetër nga stafi i brendshëm i subjektit të sektorit publik. Neni 10 Raporti vjetor i Komitetit të Auditimit -1. Komiteti i Auditimit përgatitë raport vjetor për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik. Neni 8 Takimet e Komitetit të Auditimit-1. Takimet e Komitetit të Auditimit mbahen së paku katër (4) herë në vit dhe ftohen nga kryesuesi i Komitetit të Auditimit.

NJAB funksionon me vetëm një auditor të brendshëm nga muaji gusht 2025, pas pensionimit të auditores në muajin mars 2025. Janë planifikuar katër auditime, përderisa është përfunduar vetëm një auditim i planifikuar dhe një auditim me kërkesë. Komiteti i auditimit është i përbërë nga tre anëtarë të shoqërisë civile, përderisa nuk ka anëtarë të brendshëm. Komiteti i auditimit nuk kishte përgatitë raportin vjetor për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik, si dhe janë mbajtur vetëm 2 takime.

Kjo ka ndodh për shkak se auditorja është pensionuar në muajin mars 2025, ku deri te rekrutimi i auditores në muajin gusht 2025 kanë ngecur proceset si dhe mungesa e kontrolleve adekuate për respektimin e rregulloreve në fuqi.

**Ndikimi** Mungesa e një njësie të kompletuar të auditimit të brendshëm, funksionimi jo i rregullt i komitetit të auditimit dhe mosrealizimi i planit të auditimit dobësojnë ndjeshëm kontrollin e brendshëm në komunë. Kjo rrit rrezikun për keqmenaxhim financiar, ndërkohë që problemet nuk identifikohen dhe nuk korrigjohen me kohë. Si pasojë, mund të ketë humbje të besimit nga publiku dhe institucionet mbikëqyrëse.

**Rekomandimi A5** Menaxhmenti duhet të ndërmarrë veprime të menjëhershme për funksionalizimin e plotë të sistemit të auditimit të brendshëm, duke përfshirë kompletimin e njësisë së auditimit me staf të mjaftueshëm dhe kompetent, konstituimin e Komitetit të Auditimit në përbërje të plotë sipas kërkesave ligjore, si dhe hartimin dhe zbatimin efektiv të planit vjetor të auditimit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>6</sup>	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>12,592,238</b>	<b>14,300,443</b>	<b>13,944,284</b>	<b>12,132,927</b>	<b>11,159,685</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	11,641,837	12,143,456	12,132,701	10,831,509	10,345,461
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,033,041	914,079	688,195	440,514
Të hyrat vetanake	950,401	950,401	726,520	357,502	368,928
Donacionet vendore	0	26,092	23,531	3,116	4,781
Donacionet e jashtme	0	147,453	147,453	252,604	0

Komuna për vitin 2025 kishte realizuar pagesa në vlerë 13,944,284€ apo 98% e buxhetit final. Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 1,708,203€. Kjo rritje është rezultat i vendimeve të qeverisë në vlerë 501,618€, të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 1,033,041, grantët të përcaktuara të donatorëve në vlerë 173,544€.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>12,592,238</b>	<b>14,300,443</b>	<b>13,944,284</b>	<b>12,132,927</b>	<b>11,159,685</b>
Pagat dhe mëditjet	6,865,265	7,366,884	7,357,817	6,557,218	6,157,975
Mallrat dhe shërbimet	1,514,233	1,566,535	1,526,441	1,430,944	1,540,810
Komunalitë	225,000	250,403	242,698	200,562	147,744
Subvencionet dhe transferet	514,157	588,656	567,074	507,425	360,285
Investimet Kapitale	3,473,583	4,527,964	4,250,254	3,436,778	2,952,871

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 501,618€. Kjo rritje ishte si rezultat i vendimit të Qeverisë nr.03/261, i datës 05.06.2025, në vlerën prej 296,872€ dhe Vendimit të Qeverisë nr. 02/281, i datës 24.12.2025, në vlerën prej 204,746€. Realizimi për këtë kategori ishte 100%;


Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 52,302€. Rritja ishte ndikuar nga të hyrat vetanake të bartura në vlerë 49,902€, si dhe 2,400€ nga donacionet. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 97%;

Buxheti final për shpenzimet komunale në raport me buxhetin fillestar kishte rritje për 25,403€. Rritja ishte ndikuar nga të hyrat vetanake të bartura nga viti 2024. Shpenzimet në këtë kategori ishin 97%;

Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 74,485€. Rritja ishte ndikuar nga të hyrat vetanake të bartura në vlerë 50,954€, si dhe 23,530€ nga donacionet. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori ishte 96%;

Buxheti për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,054,233€. Rritja ishte ndikuar nga të hyrat vetanake të bartura në vlerë 906,781€, si dhe 147,452€ nga donacionet. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 93%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga Komuna në vitin 2025 ishin 800,488€, derisa ishin planifikuar 950,401€, duke mos realizuar planin planin për 149,913€. Ato kanë të bëjnë kryesisht nga taksat për leje ndërtimore, tatimi në pronë, të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike, participimet, si dhe taksa tjera komunale. Arsye e mos përmbushjes së planit të të hyrave ishte realizimi i ulët i të hyrave nga tatimi në pronë, nga i cili ishin planifikuar 430,752€ dhe ishin realizuar vetëm 271,645€ apo 63%.

Në vitin 2025 Komuna ka përfituar 210,387€ të hyra nga gjobat në trafik, 18,402€ nga gjobat e gjykatave dhe 9,096€ €, nga Agjencioni i Pyjeve, apo në total 237,885€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe i inkasojnë institucionet përkatëse.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>950,401</b>	<b>950,401</b>	<b>800,488</b>	<b>743,843</b>	<b>884,219</b>
Të hyrat tatimore	430,752	430,752	271,645	310,633	443,998
Të hyrat jo tatimore	519,649	519,649	526,800	432,959	440,162
Të hyrat tjera	0	0	2,043	252	59


## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2024 ka rezultuar me 12 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, katër (4) rekomandime janë zbatuar, një (1) pjesërisht dhe shtatë (7) rekomandime nuk janë adresuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar saktë në regjistrat kontabël sipas kërkesave ligjore.	Situatë e ngjajshme është evidentuar edhe gjatë vitit 2025.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që të përforcohen kontrollet dhe të rritet përgjegjësia në procesin e ndarjes së fondeve për projektet kapitale, dukë i dhënë prioritet projekteve të papërfunduara nga vitet paraprake.	Situatë e ngjajshme është evidentuar edhe gjatë vitit 2025.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Edhe këtë vit komuna nuk kishte bërë asnjë inspektim të pronave të paluajtshme.	Nuk ka filluar zbatimin


4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigoroze në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat/ndëshkimet e parapara në kontratë.	Nga mostrat e testuara kemi hasur në aplikimin e masave/ndëshki meve të parapara me kontratë përderisa vazhdojnë vonesat e projekteve kapitale.	Pjesërisht i zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e faturave, duke siguruar se pagesat bëhen brenda afatit të përcaktuar ligjor.	Situatë e ngjajshme është evidentuar edhe gjatë vitit 2025.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha kontrollet e nevojshme funksionojnë gjatë tërë kohës, në mënyrë që para inicimit të procedurave të prokurimit të sigurohet se projektet kapitale janë të përfshira në ligjin e ndarjeve buxhetore ka fonde të mjaftueshme buxhetore të ndara për të gjitha kontrata e lidhura.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur gjetje të kësaj natyre.	I zbatuar
7.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurohet se funksionon kontrolli i duhur përmes zyrës së prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësitë kërkuese bëjnë hartimin e projektit ekzekutiv sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur gjetje të kësaj natyre.	I zbatuar
8.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë së ngjarjeve që fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, të nxjerrët urdhërblerja dhe më pas pranimi i mallrave/punëve.	Nuk është i aplikueshëm më.	I zbatuar
9.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV.	Edhe këtë vit kemi hasur në raste të keqklasifikimit të shpenzimeve. Shpenzimet ishin rezultat i ekzekutimit të shpenzimeve sipas vendimeve gjyqësore.	Nuk ka filluar zbatimin
10.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik.	Situatë e ngjajshme është evidentuar edhe gjatë vitit 2025.	Nuk ka filluar zbatimin

11.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e të arkëtueshmeve, si dhe rritjen e efikasitetit për arkëtimin e tyre. Po ashtu të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve si dhe të krijojë strategji të mbledhjes së tyre, përfshirë dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme ligjore për inkasim.	Kishte rritje të llogarive të arkëtueshme sidomos tek tatimi në pronë. Nuk janë ndërmarrë veprime tek kjo kategori.	Nuk ka filluar zbatimin
12.	Auditimi i Brendshëm	Komuna duhet të sigurojë që NjAB të mos mbetet pa udhëheqës se NjAB-se dhe të ndërmarr masa në angazhimin e një udhëheqës se NjAB-se.	Komuna ka ndërmarrë masa për zbatimin të këtij rekomandimi vetëm sa i përket rekrutimit të Auditorës së brendshme.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Valbona Tolaj, Udhëheqëse e ekipit



Selvete Foniqi, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAÇANIK	
Data	16.06.26
Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	
Numri	164/02-14512 -1-
Shtojce	

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- **pajtohem/ nuk pajtohem/ pajtohem pjesërisht/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe**
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Sabedin Xhiti



Kryetar i Komunës së Kaçanikut

Data dhe vendi: 16.06.2026, Kaçanik

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>7</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>8</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Nënvlërësim-1.Për inventarin e brendshëm të objektit të zjarrfikësve për projektin “Ndërtimi i objektit për Zjarrfikësit - Kaçanik”, (projekt kapital) në vlerë 8,444€ dhe paisje tjera mbi 1,000€ në vlerë 24,615€. Projektet që janë evidentuar investim në vijim:1.Ndërtimi i trotuarit në rrugën regjionale Ahmet Kaçiku, segmenti Restorant-Fusha e pajtimit Faza II-të me vlerë kontrate 239,760€, raporti përfundimtar 26.11.2025; 2.Ndërtimi i shkallëve ngjitje mbi gurin e shpuar, me vlerë kontrate 217,999€, raporti përfundimtar 10.09.2025; 3.Ndërtimi dhe rregullimi i terreneve sportive në bashkësitë lokale Doganaj-Soponicë dhe Duraj, me vlerë kontrate 260,885€, raporti përfundimtar 22.12.2025; 4.Ndërtimi i urës mbi lumin Nerodime-Faza II, me vlerë kontrate 68,489€, raporti përfundimtar 31.07.2025; 5.Ndërtimi i murit mbrojtës te Çerdhja e Fëmijëve Agimi Kaçanik, me vlerë kontrate 108,132€, raporti përfundimtar 03.06.2025 dhe 6.Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHFMU Idriz Seferi, Bob, me vlerë aneks kontrate 36,500€ (investim në vijim 199,763€, raporti përfundimtar 06.11.2025. Mosregjistrim përmes sistemit e-pasuria hyrje/dalje: furnizim me veshmbathje me vlerë 4,920€; paisje tjera me vlerë 5,219€;furnizime mjekësore 5,512€;furnizime për zyrë me vlerë 7,531€; furnizime mjekësore për laborator me vlerë 11,954€.
- <sup>6</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>7</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>8</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.